



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

**P.nr. 532/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e sekretares juridike Arjeta Kelmendi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B K nga Peja, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme, PP//nr.271/15 të dt.11.05.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurorit të shtetit Lumturie Hoxha, i akuzuari B K, dhe në mungesë të dëmtuarit R M, me dt.26.10.2017 dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

B K, i biri i Q dhe nënës M e gjinisë B, i lindur me dt. ...., në Pejë, ku edhe banon rruga “.....”, nr., i ....., ka të kryer shkollën ...., gjendjes së..... ekonomike, më nr. personal ..... dhe me nr. tel. ...., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me datë 16.02.2015, gjatë orëve të natës në Pejë në rr. “.....” nr...., në shtëpinë e të dëmtuarit R M, me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë merr pasurinë e luajtshme, pronë e të dëmtuarit në atë mënyrë që i pandehuri niset nga shtëpia e tij i pajisur me një karrocë dore dhe disa çelsa, për hapjen e bulonave dhe pasi arrin të shtëpia e të dëmtuarit, afrohet te një eskavator dhe një kamion, të cilat ishin të parkuara në skaj të rrugës, pasi sigurohet se, nuk gjendet askush me pajisjet që i kishe marrë me vete, arrin të nxjerrë një bateri të markës “V-S” me ngjyrë të bardhë 165 amperë, dhe një bateri të markës “” 110 amperë, si dhe nga kamioni merre 50 litra naftë dhe nga eskavatori gjithashtu 50 litra naftë, ku të gjitha gjerat e vjedhura me pas me karroc dore i dërgon në shtëpi e axhës së tij, S K, ku me pas policia gjatë bastisjes së shtëpisë në fjalë gjënë bateritë e të dëmtuarit dhe të njëjtat me pas i kthehen pronarit

-Me çka ka kryer vepër penale, të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 325 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin:

**E GJYKON**

Dënim me gjobë në lartësi prej 150 (njëqind) euro.

Të akuzuarit B. K i përcaktohet edhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj dhe ky dënim me burgim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Dënimin me gjobë i cekur si me lartë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar atëherë i njëjti dënim do të shndërrohet në dënim burgu duke ju llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale ti paguaj gjykatës shumën prej 15 Euro, si dhe në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor shumen prej 25 Euro, dhe 30 Euro në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar R M, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.271/15 datës 11.05.2017, kundër të akuzuarit B K për shkak të veprës penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit PP/II.nr.271/15 datës 11.05.2017 në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë i akuzuari B K ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurorja ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vullnetshëm dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit dhe vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform neni 253 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka shpall fajtor te pandehurin bazuar ne pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit si dhe bazuar në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër 2015-DA-0311 datës 16.02.2015, raporti i

policit B. B i datës 16.02.2015, deklarata e të dëmtuarit R M dhënë në polici me datë 16.02.2015, deklarata e të akuzuarit të dhënë në polici me datë 24.02.2015, deklarata e dëshmitarit Q K dhënë në polici me datë 16.02.2015, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, certifikatën mbi dorëzimin e datës 16.02.2015, fotoalbumi raporti, fillestar i incidentit me numër 2015-DA-0274, i datës 11.02.2015, raporti i policit A. M. i datës 11.02.2015, deklarata e të dëmtuarit A. B., e datës 11.02.2015, deklarata e të dëmtuarit R M dhënë në prokurori e datës 29.12.2016, si dhe shkresat e tjera të lëndës .

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se: i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje korrekte para gjykatës, premtori se nuk do të përsëriten veprime të tilla. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPK-së.

Gjykata konform nenit 450 të KPPRK-së, të akuzuarin e obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nen par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit e obligoj me pagesën në shumën si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 të KPPRK-së gjykata e udhëzon në kontest civil palën e dëmtuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365, të KPPK-së.

## **NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.532/17**

Sekretarja juridike  
Arjeta Kelmendi

GJYQTARJA  
Violeta Husaj – Rugova

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.